

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rama shkarkon Vlora Hysenin
ADRESA	https://lapsi.al/lajmi-i-fundit-rama-shkarkon-vlora-hysenin-i1094228
BURIMI	lapsi.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 05:36:01 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	22 shtator 2026, 13:39:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c755cd16dc5d6b9000cd904efaada24e84d64392f9dd0136f0b52644ba2d555
TEKSTI	e65d03abf0923e94a3f5297dbca5b1816983f31c8cefa766fc605c353ff2aa64
PAMJA	aa2ff6b5fde2fa50cdf5d7611e25d38ab15f9143263e78f2940d59b965e90367

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0620ae31dba4dc6a65816782fbeb8579b1189d34353029f37e1d62b989cba14
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9a62bc48d128c347cbec1d2f32b4c754e5d530aa01fd4a64b6b1015f32f32417
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/0620ae31dba4dc6a65816782fbeb8579b1189d34353029f37e1d62b989cba14

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Rama shkarkon Vlora Hysenin

LAPS1.AL • 22 SEPTEMBER 2025



Kryeministri Edi Rama ka reaguar nga Nju Jorku pas masës së arrestit në shtëpi të vendosur nga SPAK ndaj drejtoreshës së Shërbimit Informativ të Shtetit, Vlora Hyseni.

Në një tjetër piruetë të detyruar, Rama thotë se (ndryshe nga si veproi në rastin e Ballukut) pret që çdo dyshim i ngritur nga organi i akuzës të hetohet dhe të zbardhet deri në fund nga drejtësia, duke theksuar se askush nuk mund të jetë mbi ligjin, pavarësisht funksionit publik.

"Përtej respektit për punën dhe për personin e Vlora Hysenit, si edhe po ashtu përtej vlerësimeve të vazhdueshme që ajo ka marrë nga agjencitë partnere si drejtuese e shërbimit inteligjent shqiptar, rruga pa kthim që kemi zgjedhur është rruga e pavarësisë së organeve të drejtësisë për të hetuar e gjykuar këdoqoftë", shprehet Rama.

Kryeministri kritikoi gjithashtu mënyrën se si çështjet penale ndaj zyrtarëve publikë, sipas tij, kthehen menjëherë në beteja politike dhe mediatike, përpara se gjykatat të japin një vendim përfundimtar.

Rama kundërshtoi edhe interpretimin se hetimet ndaj zyrtarëve të lartë përbëjnë akuzë ndaj vetë mazhorancës, duke argumentuar se qeveria socialiste ishte ajo që krijoi kushtet për pavarësinë e institucioneve të reja të drejtësisë.

"Çdokush është i pafajshëm deri në gjykimin përfundimtar, po askush nuk është mbi ligjin në asnjë rast e për asnjë arsye", deklaroi ai.

Rama tha se nuk do të komentojë mbi themelin e dosjes dhe as nuk do të marrë në mbrojtje Hysenin përballë drejtësisë, duke e cilësuar përgjegjësinë penale si çështje individuale mes personit nën hetim, prokurorisë dhe gjykatës.

Në fund të reagimit, kryeministri njoftoi se Vlora Hyseni do të lirohet menjëherë nga detyra e drejtoreshës së SHISH-it.

"Lirimi nga detyra i drejtores së shërbimit është i menjëhershëm, e sapo të kthehem në

ide



Rënia e Vlorës në shtratin e krimit
Armand Shkullaku



Haga, si përfundim i një epoke të gjatë yes man-izmi
Andi Bushati

MOTITIRANA

24°C

KËMBIMIEURO

91.40

aktuale

09:28

Protesta nuk ndalet, qytetarët rikthehen sot para Kryeministrit: Rama jep dorëheqjen

19:41



"Nuk shitet Shqipëria, shitet qeveria", 114 ditë revoltë kundër qeverisë në bulevard



TIA dhe Vodafone sjellin teknologjinë Airbus në Tiranë

Ndiqe Lapsin edhe në



Me interes nga publiku



Tiranë dhe në konsultim me Presidentin e Republikës, do të zgjedhim drejtuesin e ri të Shërbimit Informativ të Shtetit”, deklaroi Rama.

Reagimi:

Për shkak të orareve të ndryshme ky reagim nga Nju Jorku, ku jam për Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së, mund të duket i vonuar dhe ndjesë për këtë. Jam informuar lidhur me masën e arrestit shtëpiak që SPAK-u ka nxjerrë për drejtoren e Shërbimit Informativ të Shtetit, e pres që çdo dyshim i organit të akuzës të hetohet dhe zbardhet deri në fund përmes procesit të pavarur gjyqësor. Përtej respektit për punën dhe për personin e Vlora Hysenit, si edhe po ashtu përtej vlerësimeve të vazhdueshme, që ajo ka marrë nga agjencitë partnere si drejtuese e shërbimit inteligjent shqiptar, rruga pa kthim që kemi zgjedhur është rruga e pavarësisë së organeve të drejtësisë për të hetuar e gjykuar këdoqoftë, pavarësisht statusit social apo funksionit publik. Por po ashtu, është e pashmangshme mesa duket, që çdo hetim apo masë e marrë nga drejtësia në adresë të personave publikë, të kthehet në një motivim për të grirë mish njeriu në mexhelisin politik e mediatic dhe për të thirrur “litarin” si në sheshet e ekzekutimit mesjetar, kohë përpara sesa gjykata të thotë fjalën e saj. E megjithatë, kurrësesi nuk mund të jetë e vërtetë që veprimet e pavarura të drejtësisë dhe afirmimi i vijueshëm i barazisë para ligjit, të jenë njëkohësisht akt-akuza kundër pikërisht një shumice qeverisëse e cila me kurajo e me vendosmëri, ia ka çelur rrugën drejtësisë së pavarur, në një vend ku deri para shumë pak vitesh kjo pavarësi ishte e paimagjinueshme prej shekujsh. As mund të jenë këto zhvillime me drejtësinë baltë kundër Shqipërisë, e cila po bën në rrugën e saj të bashkimit me Europën shumëçka që as nuk mund të imagjinohet akoma në vendet e tjera të rajonit dhe që koha do ta çmojë më mirë se sa kushdo. Çdokush është i pafajshëm deri në gjykimin përfundimtar po askush nuk është mbi ligjin në asnjë rast e për asnjë arsye, kështu që unë i jam falenderues Vlora Hysenit për çdo gjë që ka bërë si duhet në shërbim të Shqipërisë, ndërsa për gjithçka tjetër që ka të bëjë me çështjen e sapohapur nga organet e drejtësisë, qëndrimi im mbetet po ai i ditës së parë të Reformës në Drejtësi: Pafajësia ose fajësia e një bashkëpunëtori të vendosur nën akuzë është një çështje individuale përballë prokurorisë e gjykatës dhe kjo shumicë qeverisëse me mua në krye, i mbetet besnike këtij qëndrimi duke mos hyrë në meritën e asnjë çështjeje të drejtësisë dhe duke mos bërë avokatinë e askujt që përballët me drejtësinë. Lirimi nga detyra i drejtores së shërbimit është i menjëhershëm, e sapo të kthehem në Tiranë dhe në konsultim me Presidentin e Republikës, do të zgjedhim drejtuesin e ri të Shërbimit Informativ të Shtetit.

Të këshilluara



Euro prek rekord të ri, 91.4 lekë

Kursi i këmbimit të Euros me Lekun po pëson rënie të mëtejshme këtë javë. Sipas kursit zyrtar të këmbimi...



Mediat bojkotojnë Trump, hakmarrje për dëbimin e gazetarëve

Rrjetet kryesore televizive në Shtetet e Bashkuara pezulluan transmetimin e aktiviteteve të presidentit Donald Trump, në shenjë hakmarrjeje...



Aplikacioni për komunikime sekrete/ Si flet Belinda Balluku me Skënder Hitën (VIDEO)



SPAK lëshon masë sigurie për kreun e SHISH/ Vlora Hyseni pezullohet nga detyra



Berisha nxjerr VIDEON/ Pjerin Ndreu u përplas me shqiptarët e takimit të Ramës në Michigan



Përkrahje e autorit të krimit dhe nxjerrje të sekretit hetimor, zbulohen akuzat që përballët Vlora Hyseni pas aksionit të SPAK



OKB: Mbi 240 mijë persona mund të zhvendosen nga përshkallëzimi i konfliktit në Jemen



SPAK reagon zyrtarisht për "arrestin" e shefes së SHISH

SPAK ka reaguar për masën e sigurisë ndaj drejtoreshës së SHISH-it, Vlora Hyseni, por njoftimi nuk ka asnjë shpjegim mbi thelbin ...



Ankimoi masën, Apeli i GJKKO lë në burg Ergys Agasin

Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Posaçme ...



Berisha: Vlora Hyseni u bëri presion gjyqtarëve të Kushtetueses në çështjen e Belinda Ballukut

Kreu i Partisë Demokratike, Sali Berisha, ka reaguar pas masës së sigurisë "arrest në shtëpi" të vendosur nga GJ...



Flying Tiger Copenhagen po zgjeron praninë e saj në tregjet e rajonit, pas hyrjes në Shqipëri



Denoncimi i Berishës: Vlora me Gysin dreka dhe darka dy herë në jave te një lokal poshtë shtëpisë sime

Kryetari i PD-së, Sali Berisha deklaroi se SHISH drejtohej nga Ergys Agasi, duke marrë spunto kështu dhe nga aksioni i sotëm i SPAK që...



Berisha: Viora Hyseni uraneroi qe çdo informacion të dërgohej fillimisht te Rama dhe Agaçi

Kreu i Partisë Demokratike, Sali Berisha, reagoi pas masës së sigurisë ndaj drejtoreshës së SHISH, Viora Hyseni, duke e konsideru...



Arrestimi i Viora Hysenit/ Berisha: Hera e parë që një shefe e shërbimit sekret ishte në funksion të krimit

"Në histori keni lexuar, keni dëgjuar që shefat e shërbimeve të kenë punuar në kundërshtim me ligjet për diktator&...

Me sytë katër



22:10

E RRALLE/ Trump del në TV pa zë për shkak të bojkotit të mediave

Një skenë e papritur ndodhi të hënën (21/9) në një aktivitet në Shtëpinë e Bardhë, ku Presidenti i SHBA-...




Berisha nxjerr VIDEON/ Pjerin Ndreu u përplas me shqiptarët e takimit të Ramës në Michigan

21:02



Pamjet/ Sherr me shkopinj mes lojtarëve të rinj të hokejit në akull

20:20



Pamjet shokuese në Brazil/ Nxënësja 17-vjeçare sulmon me thikë mësuesen

20:29



"Për Enverin yll e dritë"/ Ç'ndodhi në praninë e kryebashkiakes së Lushnjës

18:31

SPORT

→ Të tjerë artikuj



15:08

Izraeli i përgjigjet trajnerit të Irlandës: "Ende nuk kemi zbuluar kurën për budallallëkun dhe injorancën"




13:48

Futbollisti më i pasur në botë nuk ka skuadër: është i papunë me një pasuri prej 18 miliardë eurosh




13:43

Një i mitur fshihet poshtë autobusit të Valladolid dhe hyn në Spanjë: "Lojtarët dëgjuan zhurma"



12:15



11:10

Revolucion ne Formula 1!
Nga viti 2027, Çmimet e
Mëdha më të shkurtra e
rregulla të reja për
ndërprerjet

11:40
Stërvitja e parë e Zidane
si trajner i Francës me
vetëm 12 lojtarë: disa
ishin të shqetësuar

11:40
Një printer dhe fotoja e
Special One: ja si Atletico
Madrid poshtëroi
teknikun Mourinho

Gabi ben nje gjest te
turpshëm, Rüdiger del
nga kontrolli: ana e
shëmtuar e Atletico-Real
Madrid

PAPARAZZI



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.